

KËRKIME GJUHËSORE

Anila KANANAJ

MBI DALLIMIN E RRETHANORIT NË NDËRTIMET ME PARAFJALË TË SHQIPES

Dallimi i rrethanorit në ndërtimet parafjalore të shqipes përbën një çështje me interes për gjuhësinë shqipe, aq më tepër që për këtë është folur pak nga albanologët (Gramatika, 1996: 269–281; Përnaska, 1970 & 1996). Studimet e deritanishme përdorin kriterin e përgjithshëm të pyetjes me parafjalë dhe një kriter më specifik, atë të vepruesit frymor, për të përcaktuar funksionin kundrinor apo rrethanor të një sintagme parafjalore të shqipes. Kështu, nëse një sintagmë parafjalore i përgjigjet një pyetjeje me parafjalë, ajo luan rolin e kundrinës në fjali. Ndërsa në rastin e kundërt, pra kur nuk i përgjigjet pyetjes me parafjalë në këto ndërtime, kryen funksionin e rrethanorit. Në sintagmat parafjalore që shprehin veprim a marrëdhënie hapësinore hyn në punë kriteri i të qenit frymor për të dalluar kundrinat. Mbështetur në këto kritere, te kundrina me parafjalë futen edhe ndërtime parafjalore që në thelb shprehin kuptime rrethanore.

Ky studim ka për qëllim vendosjen e kriterëve të reja, mbështetur në gramatikën gjenerative, për dallimin e rrethanorit nga kundrinori me parafjalë në ndërtimet parafjalore të shqipes. Në sajë të kësaj pune kërkimore janë hartuar, testuar dhe kristalizuar tri kritere kryesore që shërbejnë për dallimin e rrethanorëve nga kundrinorët me parafjalë. Këto kritere përbëjnë një risi për gramatologjinë shqipe në lidhje këtë çështje. Në bazë të këtyre kriterëve synohet të bëhet dallimi i qartë i rrethanorit në ndërtimet me parafjalë të shqipes.

1. Kriteret e dallimit të rrethanorit nga kundrinori me parafjalë

Në sajë të punës sonë kërkimore kemi arritur të kristalizojmë këto tri kritere që mund të bëjnë dallimin e kundrinorit nga rrethanori në ndërtimet me parafjalë të shqipes:

Kriteri i fakultativitetit

Kriteri i zëvendësimit

Kriteri tematik

Le t'i shqyrtojmë me radhë këto kritere.

1. Kriteri i fakultativitetit

Në përgjithësi kundrinorët mendohen si gjymtyrë të domosdoshme të fjalisë, ndërsa rrethanorët konsiderohen tradicionalisht si elemente periferike të fjalisë, si gjymtyrë fakultative, dmth. njësi që mund të shtohen ose të hiqen lirshëm nga fjalia (Radford, 1988: 175-187; Meyers etj., 1996:3). Roli i tyre në fjali ka të bëjë me dhënien e informacionit shtesë për kohën, vendin, shkakun, qëllimin etj. e kryerjes së veprimit të shprehur nga predikati¹. Fakultativiteti është kështu tipar kryesisht i rrethanorit. Kundrinorët nuk e plotësojnë këtë kriter. Fakultativiteti i një sintagme parafjalore përbën edhe kriterin e parë që mund të

¹ Bën përjashtim rasti kur përdoren me predikatin emëror. Në këtë funksion ata janë gjithnjë të domosdoshëm.

përdoret për ta dalluar atë nga kundrinori në ndërtimet parafjalore të shqipes. Ta ilustruajmë me një shembull:

Ata e luftuan armikun *me shpatë*.

Sintagma parafjalore *me shpatë* mund të hiqet dhe fjalia përsëri mbetet gramatikore:

Ata e luftuan armikun.

Kjo do të thotë që sintagma parafjalore *me shpatë* përmbush kriterin e fakultativitetit, prandaj është rrethanor dhe jo kundrinor.

Një pjesë e mirë e rrethanorëve të shqipes janë fakultativë, por duke qenë se kjo kategori në shqipe është mjaft e zgjeruar, një pjesë e rrethanorëve përmbushin kriteret për të qenë të domosdoshëm. Kështu, rrethanorët e vendit që shprehin vendndodhje, pra lokativët, janë jo rrallë të tillë:

(3) Ergi shkon *në shkollë*.

Në këtë shembull, rrethanori i vendit *në shkollë* është i domosdoshëm për kuptimin e fjalisë. Eliminimi i kësaj SP do bënte fjalinë jo gramatikore:

(4) *Ergi shkon.

E njëjta gjë mund të thuhet për ndajfoljet e mënyrës:

(5) Djali u ndie *mirë/keq*.

(6) *Djali u ndje.

2. Kriteri i zëvendësimit

Kriteri i dytë që na hyn në punë për dallimin e kundrinorit nga rrethanori në ndërtimet parafjalore të shqipes është kriteri i zëvendësimit të një sintagme parafjalore me një emër në kallëzore ose dhanore. Në një rast të tillë ajo është kundrinë dhe jo rrethanor (kusht i mjaftueshëm, por jo i domosdoshëm). Kjo përbën dhe kriterin e dytë të përdorur në studimin tonë. Të marrim një shembull:

(7) Përgjegjësia kryesore rëndonte *mbi menaxherin*.

Sintagma parafjalore *mbi menaxherin* mund të zëvendësohet me një emër në dhanore:

(8) Përgjegjësia kryesore i rëndonte *menaxherit*.

Pra, sintagma *mbi menaxherin* kryen funksionin e kundrinës në fjali. Të marrim një shembull tjetër:

(9) I foli *në vesh*.

Zëvendësimi i sintagmës parafjalore *në vesh* me një emër në kallëzore apo dhanore do të rezultonte në një fjali gramatikore, siç tregohet më poshtë:

(10)* I foli *veshin/veshit*.

Rrjedhimisht sintagma parafjalore *në vesh* kryen funksion rrethanor në fjali.

3. Kriteri tematik

Kriteri i tretë që ndihmon në përcaktimin e funksionit të një sintagme parafjalore në fjali është kriteri tematik. Ky kriter përqendrohet në funksionin semantik të sintagmave në fjali, i cili njihet me termin *rol tematik*. Numri i roleve tematike të përshkruara ndryshon në autorë të ndryshëm, por në përgjithësi pranohen këto role tematike:

1. *Vepruesi* - bërësi i ndërgjegjshëm ose i pandërgjegjshëm i një veprimi. Karakterizohet nga prania ose nënkuptimi i ndajfoljeve të tilla, si: *qëllimisht, me qëllim që* etj.:

(11) *Lola* (veprues) bëri detyrat.

(12) *Era* (veprues) theu pemët.

(13) Pemët u thyen *nga era* (veprues).

2. *Pësuesi* - objekti i drejtpërdrejtë i veprimit të një foljeje, gjendja e të cilit ndryshon pas veprimit; p.sh. kundrina e drejtë e foljeve *ha, qëlloj, godas, thyej* etj.:

(14) *Dritarja* (pësues) u thye.

(15) *Lola* pa *Lizën* (pësues).

4. *Tema* - objekt i veprimit të foljes, njësia që lëvizet, ndryshon pozicion ose gjendje:

(16) *Unë (temë)* eci/vdes.

5. *Përjetuesi* - pjesëmarrësi që përjeton një ndjenjë apo emocion, p.sh. kryefjala e foljes *dua* ose kundrina e foljes *mërzit*:

(17) *Shoku* (përjetues) do shoqen.

(18) *Shoku* e mërziti *shoqen* (përjetues).

6. *Përfituesi* - Qenia a njësia që (a) *përfiton* nga një veprim ose (b) *merr* diçka në zotërim:

(19) *Ai* i dha *motrës* (përfitues) një dhuratë për ditëlindje.

(20) *Lola* (marrës) mori *librin* (temë) *nga Deivi* (veprues).

7. *Lokativi* – hapësira, pozicioni a pika në të cilin lokalizohet ose ndodh një veprim:

(21) *Shkoj në Tiranë* (lokativ).

8. *Pikësynimi* – objekti apo pika drejt të cilës orientohet a shkon lëvizja:

(22) *Ai* vrapoi *për në dyqan* (pikësynim).

(23) *Makina* udhëtoi *nga Tirana* (burim) *për në Durrës* (pikësynim).

9. *Burimi* – objekti a pika nga e cila rrjedh veprimi:

(24) *Unë* mora stilolapsin *nga sirtari* (burim).

(25) *Unë* mora një letër *nga motra* (burim).

Nga kjo paraqitje e roleve tematike, konkludojmë që rolet tematike të *pësuesit, temës, përjetuesit dhe përfituesit* i merr kundrinori:

(26) *Ergi* theu *dritaren* (pësues).

(27) *Portieri* kapi *topin* (temë)

(28) *Ergi* e mërziti *Anën* (përjetues).

(29) *Ai* i dha *shokut* një dhuratë (përfitues).

Rolet tematike të lokativit, burimit ose pikësynimit i merr rrethanori:

(30) *Shkoj në kinema* (lokativ).

(31) *Makina* udhëtoi *nga Tirana* (burim) *për në Durrës* (pikësynim).

2. Dallimi i rrethanorit në ndërtimet parafjalore të shqipes

Dallimi i funksionit të gjithë tipave të sintagmave parafjalore përbën një objekt shumë interesant, por në këtë studim do të përqendrohemi vetëm te sintagmat parafjalore me funksion rrethanor. Ndër sintagmat parafjalore që mund

të merren në studim për kryerjen e funksionit të rrethanorit në fjali rendisim sintagmat parafjalore që shprehin kuptimet e mjetit, burimit, pikësnyimit, lokativit, motivimit, kufizimit, shoqërimit. Le t'i shqyrtojmë me radhë.

a) *Sintagmat parafjalore të mjetit*

Sintagmat parafjalore *me traktor, me thikë, në telefon* shprehin mjetin e realizimit të veprimit në fjalitë më poshtë:

(30) Toka u punua *me traktor*.

(31) Gjyshja e preu bukën *me thikë*.

(32) Dje fola në telefon *me prindërit*.

Në shembullin *u punua* është folje pësore. Si e tillë ajo nuk mund të marrë kundrinë, prandaj sintagma parafjalore *me traktor* kryen funksion rrethanor. Edhe kur folja është në veprorë, sintagmat *me thikë, në telefon* janë fakultative, për pasojë luajnë rolin e rrethanorit.

b) *Sintagma parafjalore të burimit dhe pikësnyimit*

Të shqyrtojmë sintagmat parafjalore që shprehin kuptime të burimit dhe pikësnyimit. Le të shohim dy shembuj:

(33) Ne duhet të kalojmë *nga fjalët te veprat*.

(34) Trimat shqiptarë shkonin *drejt vdekjes me ballin lart*.

(GA II, 1996: 268)

Në shembullin (33) sintagmat parafjalore *nga fjalët* shpreh burim, sintagmat *drejt vdekjes dhe te veprat* shprehin burim. Në bazë të kriterit tematik që përcaktuam më lart, ato funksionojnë si rrethanorë.

c) *Sintagmat parafjalore lokative*

Të japim disa shembuj të përdorimit të sintagmave parafjalore lokative:

(35) Fjala e tij mbështetet *në fakte*.

(36) Biseda u vërtit *rreth studentëve*.

(37) Një ide i ishte ngulitur fort *në mendje*.

Sintagmat parafjalore *në fakte, rreth studentëve, në mendje* kanë kuptimin e lokativit, rrjedhimisht janë rrethanorë.

d) *Sintagmat parafjalore të motivimit*

Sintagmat parafjalore të motivimit shprehen me folje, si: *qahem, ankohe, mburrem, krenohem, vuaj etj.*, të cilat në strukturën e tyre semantike kërkojnë motivim:

(38) Ai ankohej *për shëndetin e lig*.

Kundrina nuk mund të krijojë marrëdhënie tematike motivuese me foljen, prandaj sintagma *për shëndetin e lig* është rrethanor shkaku. Për të njëjtën arsye, të gjitha sintagmat parafjalore të motivimit janë rrethanorë.

e) *Sintagma parafjalore të kufizimit*

Të shqyrtojmë disa sintagma parafjalore që shprehin kufizim:

(39) Erdha *te ti*.

(40) Filloje *nga Arditi*.

(41) Fillojmë *me analizën*.

Nëse do të provojmë të zëvendësojmë sintagmat parafjalore në (39) dhe (40) me një emër në dhanore ose kallëzore, fjalitë do të bëheshin jo gramatikore:

(42) *Erdha ty.

(43) *Filloje *Arditin/Arditit*.

Për më tepër, sintagmat *në* me të zeza në (39) dhe (40) kanë kuptim lokativ në një kuptim të gjerë, prandaj mendojmë se luajnë rolin e rrethanorit. Sintagma parafjalore *me analizën* në (41) mund të zëvendësohet me një emër në kallëzore:

(44) Fillojmë *analizën*.

Atëherë sipas kriterit të zëvendësimit sintagma *me analizën* është kundrinor.

f) Sintagmat parafjalore të shoqërimit

Dhe së fundi të shqyrtojmë sintagmat parafjalore të shoqërimit.

(45) Luftoi kundër armiqve.

(46) Fola *me shoqen* për detyrën e kursit.

(47) E pashë tek ecte rrugës *me të shoqin*.

Sintagmat parafjalore *kundër armiqve* në (45) dhe *me shoqen* në (46) mund të zëvendësohet me një emër në kallëzore, përkatësisht dhanore:

(48) Luftoi *armiqtë*.

(49) I fola *shoqes*.

Sipas kriterit të zëvendësimit sintagmat parafjalore *kundër armiqve* në (45) dhe *me shoqen* në (46) janë kundrinorë. Në fjalinë (47) sintagma parafjalore *me të shoqin* është fakultative. Ajo mund të hiqet dhe fjalia mbetet gramatikore:

(50) E pashë tek ecte rrugës.

Rrjedhimisht duke u mbështetur në kriterin e fakultativitetit sintagma parafjalore *me të shoqin* luan rolin e rrethanorit në fjalinë (47).

Siç shihet, përdorimi i koncepteve gjenerative në dallimin e rrethanorit në ndërtimet me parafjalë të shqipes jep rezultate të frytshme. Sidoqoftë, shtrojmë nevojën e një studimi edhe më të thellë që të testojë dhe përpunojë më tej këto kritere për dallimin e rrethanorit nga kundrinori në sintagmat parafjalore jo vetëm të shqipes së shkruar, por edhe të gjuhës folur.

Përfundime

Në këtë artikull u përcaktuan tri kritere kryesore për dallimin e rrethanorit nga kundrinori me parafjalë në ndërtimet parafjalore të shqipes: 1) kriteri i fakultativitetit; 2) kriteri i zëvendësimit; 3) kriteri tematik. Në bazë të këtyre kritereve sintagmat parafjalore që shprehin kuptimet e mjetit, burimit, pikësnyimit, lokativit dhe të motivimit luajnë rolin e rrethanorit në fjali, ndërsa sintagmat parafjalore që shprehin kufizim e shoqërim mund të luajnë si rolin e rrethanorit, ashtu edhe të kundrinorit në fjali, në varësi të rolit tematik që marrin në fjali.

Bibliografi

Buxheli, L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2007.

Çeliku, M. – Karapinjalli, M. – Stringa, R., *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Ilar, Tiranë, 2007.

Çeliku, M., *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde*, Ilar, Tiranë, 2008.

- Graffi, G., *200 Years of Syntax: A Critical Survey*, John Benjamins Publishing Company, 2001.
- Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1997.
- Kananaj, A., *Çështje të rrethanorit në gjuhën shqipe*, SF, Tiranë, 2008, nr. 1-2, f. 127-137.
- Kananaj, A., *Teoria e roleve tematike dhe probleme që lidhen me të në gjuhën shqipe*, SF, Tiranë, nr. 3-4, f. 111-126.
- Memushaj, R., *Bukuria e gjuhës (gjuha shqipe për klasën e tretë të gjimnazit të përgjithshëm)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2009.
- Memushaj, R., *Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*, SF, Tiranë, 2008, nr. 1-2, f. 164-165.
- Meyers, A. – Macleod, C. – Grishman, R., *Standardization of the Complement/Adjunct Distinction*, Proc. EURALEX 96 (Int'l Conf. on Lexicography), Gothenberg, Sweden, August, 1996.
- Përnaska, R., *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe, Prishtinë*, 1996.
- Përnaska, R., *Rreth disa çështjeve të kundrinave në gjuhën shqipe*, SF, 1970/4, Tiranë, f. 93-102.
- Radford, A., *Transformational grammar: a first course*, Cambridge University Press, Cambridge, 1988.

Abstract: Identifying adverbials in Albanian prepositional phrases

This article provides a new and original treatment of adverbial identification in prepositional structures in Albanian, according the generative perspective. In contrast with traditional grammar, where prepositional phrases have been defined as prepositional objects based on adverbial-question criterion, i.e. if the prepositional phrase can be the answer to an adverbial question, this study seeks to set up new criterias to distinguish adverbials in Albanian syntax. Specifically, identification of the function of prepositional phrases here is based on three main criterias: a) facultativity, b) substitution, and c) thematic roles. Particularly, the article looks at the function of prepositional phrases in instrumental, locative, source, goal, motivation and comitative uses. The language data used for this study have been collected both in written texts and spoken Albanian. The results of this work show that not all traditional prepositional objects are truly objects. On the contrary, they behave like adverbials. Finally, this study calls for greater attention to the investigation of prepositional phrases in spoken language, alongside written language, in revising and updating our knowledge of Albanian syntax.